



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 665 Prot.

Tiranë, më 08.05 2019

VENDIM Nr. 95, datë 2.05.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 2.05.2019, pasi shqyrtoi Konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Instalim antene, hapje rruge e nevojshme për në Stacion me gjatësi 412.5 m, ndërtimi i Linjës ajrore e tensionit të ulët me gjatësi 574.5m për Stacionin e telefonisë celulare të shoqërisë "VODAFON ALBANIA" sh.a., të emëruar si site "1246 Gërmenji"*, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "*Instalim antene, hapje rruge e nevojshme për në Stacion me gjatësi 412.5 m, ndërtimi i Linjës ajrore e tensionit të ulët me gjatësi 574.5m për Stacionin e telefonisë celulare të shoqërisë Vodafon Albania sh.a., të emëruar si site "1246 Gërmenji"*, paraqitur nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti "VODAFON ALBANIA" sh.a., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori "VODAFON ALBANIA" sh.a., si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Rregullores "*Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut*" (i ndryshuar) dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO